



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 18.09.2025

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 18.09.2025 :

THËRRET

Mbledhjen e IX-të, të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **26.09.2025**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e VIII-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025.
2. Pyetje legjislativiteti drejtuar ekzekutivit.
3. Propozim vendim për miratimin e Buxhetit Komunal për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028.
4. Propozim vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin "Ndërtimi i varrezave në fshatin Karaçevë e Epërme", në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Shoqatës Firishta, Karaçevë e Epërme.
5. Të ndryshme.


Liridon KASTRATI
Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYLLI
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 24199
U. 01 Br. 24199

Nr. i faq. 5 Data: 02/09
Br. str. 2025
KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VIII-të e Kuvendit të Komunës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës e mbajtur më: 28.08.2025 dhe filloj ora 10:20. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, zyra e informimit dhe përfaqësues të OSBE-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VII-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025,
2. Pyetje të Legjislativit drejtuar ekzekutivit,
3. Propozim-vendim për formimin e mekanizmit koordinues lokal për ofrimin e mbështetjes për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore,
4. Propozim-vendim për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve në PPP"ECOHIGJIENA".
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit (2025-2030).
6. Kërkesë për rishqyrtim dhe harmonizimin e vendimit sipas rekomandimeve të MAPL-së Sh.01 Nr. 17378,
7. Informata përfundimtare e procesit të Korrje-Shirjeve për vitin 2025,
8. Shqyrtimi i rekomandimit të juris për vlerësimin e punimeve për dizajnimin e stemës së Komunës së Kamenicës,
9. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës, po fillojmë me mbledhjen e tetë kuorum kemi për të vazhduar me këtë mbledhje. A keni propozim për plotësim-ndryshim të rendit të ditës, nëse nuk keni unë kam një Kërkesë nga Kryqi i Kuq lidhur me shpenzimet që i bënë për një vit, kush është që kjo pikë të hyjë në kuvend?

Për u deklaruan të gjithë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- nëse nuk ka propozime të tjera, vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës,

Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për u deklaruan të gjithë.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VII-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025,

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- e kemi procesverbalin nga seanca e fundit, a keni vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk keni e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e pikës së parë?

Për u deklaruan të gjithë.

2. Pyetje të Legjislativit drejtuar ekzekutivit,

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës, jemi në pikën e dytë të rendit të ditës, a keni diskutime rreth pikës së dytë, nëse jo kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Propozim-vendim për formimin e mekanizmit koordinues lokal për ofrimin e mbështetjes për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore.

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- e kemi një propozim-vendim për formimin e këtij mekanizmi koordinues për t'i mbështetur viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave e dhunës në baza gjinore. Ky komision përbëhet nga 16 anëtarë, pjesë e këtij propozimi është edhe Kryetari i Komunës, Kimete Kryeziu, Rifat Hajdari, Afrim Dervishi, Latif Sylaj, kemi përfaqësues të tjerë nga gjykata, nga policia, zyra për mbrojtjen e viktimave, përfaqësues nga zyra e punësimit etj. A e dëshiron dikush fjalë, nëse jo e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e pikës në tretë?

Për u deklaruan të gjithë.

4. Propozim-vendim për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve në PPP"ECOHIGJIENA"

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- kemi propozimin për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor të komisionit komuna të aksionarëve në PPP"ECOHIGJIENA". Këtu e kemi një propozim me anë të cilit caktohet kompensimi mujor për anëtarët e kësaj

ndërmarrje. Në këtë komision e kemi Arbnore Beqiraj dhe Bletë Hoxha, përfaqësuese dhe në këtë propozim-vendim kërkohet që t'i caktohet paga mujore. Shuma e kompensimit mujor për secilin anëtarë të këtij komisioni komunal aksionar të caktohet në lartësi prej 200 euro si dhe nga 50 euro për çdo takim të mbajtur por jo më shumë se katër takime brenda vitit. Deri më tani këto dy anëtarë nuk kanë pranuar pagë për punën që e kanë bërë dhe me anë të këtij vendimi e caktojmë shumën prej 200 euro si dhe 50 euro për mbledhje por jo më shumë se katër mbledhje në vit.

Labinot Haxhiu-komisioni nuk është që ndonjëherë ka sjell material e shoh një pikë ku thuhet se me vendim të veçantë do të bëhet pagesa për muajt të cilët nuk janë paguar e më pas do të do të vazhdojë të realizohet në baza mujore për secilin anëtarë për aq kohë sa ai/ajo është pjesë aktive e Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP “Ecohigjiena” (për pjesën publike KRM” Higjiena”). Nëse ka mundësi këtë me ma sqaruar dhe për ndryshe jemi për me i paguar komisionet që japin kontributin. Por pasi është votuar nga kuvendi është dashur me sjell ndonjëherë material se çka është punuar.

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- këto takime janë mbajtur në “Eco Higjiena” dhe nuk i raportojnë kuvendit, dhe na nevojiten që me i mbështet dy asamblastët të cilat kanë punuar në këtë komision.

Donjeta Ismajli-Komuna e Gjilanit dhe Vitisë kanë pasur të njëjtin komision dhe ata janë në rregull me pjesën e kompensimit vetëm komuna e Kamenicës është me vonesë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- nëse nuk keni diskutime vazhdojmë me procedurë të votimit ,

Kush është për miratimin e pikës së katërt?

Për.....14

Kundër.....1

Abstenim.....1, miratohet pika e katërt.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit (2025-2030)

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës, jemi në pikën e 5-të të rendit të ditës, për këtë pikë ja kalojmë fjalën kryetarit.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës, është hera e tretë që po votojmë në kuvendin komunal lidhur me menaxhimin e integruar të mbeturinave, kjo është e mbështetur nga organizata GIZ, organizata Gjermane. Kuvendi ka marrë një vendim i cili më pas është dashur të shfuqizohet për shkak se si i tillë nga ka qenë në përputhje me ligjin më pas me këtë ndryshim është siguruar edhe pëlqimi nga ministria për këtë pëlqim ministror ne do ta votojmë si kuvend dhe kjo të hyjë në fuqi. Ku bëhet fjalë për komunën e Gjilanit, Ferizajit, Kaçanikut, Kamenicës, Vitisë dhe Hanit të Elezit, Shtimës, dhe Novo Bërdës.

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- a e dëshiron dikush fjalën për këtë pikë, nëse jo vazhdojmë me procedurë të votimit,

Kush është për miratimin e pikës së 5-të?

Për.....16

Kundër.....0

Abstenim..... 0, miratohet pika e pestë

6. Kërkesë për rishqyrtim dhe harmonizimin e vendimit sipas rekomandimeve të MAPL-së Sh.01 Nr. 17378,

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- jemi në pikën e 6-të të rendit të ditës fjala është për objektin shumë funksional në fshatin Muçivërcë në shërbim të komunitetit kemi këtë vendim për harmonizim nga MAPL kanë konstatuar se ky vendim duhet të ndryshohet ligji në preambulën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës dhe ne e kemi bërë një propozim-vendim tjetër të cilit ja bashkëngjisim këtij ndryshimi kërkohet fillimisht ta votojmë këtë propozim-vendim i cili i bashkëngjitet këtij vendimi e pastaj me vendimin final. A e dëshiron dikush fjalën, nëse jo vazhdojmë me procedurë të votimit, që ky propozim-vendim t'i bashkëngjitet të ndryshohet.

Kush është për miratimin e pikës së 6-të?

Për.....16

Kundër.....0

Abstenim.....0

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës-vazhdojmë me miratimin e vendimit final të fshatin Muçivërc për ndërtimin e objektit shumë funksional,

Kush është për?

Për.....16

Kundër.....0

Abstenim.....0

7. Informata përfundimtare e procesit të Korrje-Shirjeve për vitin 2025,

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- informatë për korrje-shirje për vitin 2025, nëse nuk është prezent dikush nga drejtoria e Bujqësisë e shtymë këtë pikë për seancën e shtatorit?

Kush është që kjo pikë të shtyhet ?

Për.....16

Kundër.....0

Abstenim.....0

8. Shqyrtimi i rekomandimit të jurisë për vlerësimin e punimeve për dizajnimin e stemës së Komunës së Kamenicës,

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- jemi në pikën e 8-të të rendit të ditës, fjalën ja kalojmë Valdete Berisha,

Valdete Berisha-Zyrtare e Lartë për Informim dhe Raportim-si kryesuese e këtij grupi punues kemi shqyrtuar 8 propozime, ku të gjitha propozimet nuk i kanë përmbushur saktësisht kriteret e thirrjes së shpalljes, për këtë arsye juria ka vendosur që me vota nga 5 anëtarë siç e keni në rekomandim . këto shqyrtime dhe gjithë thirrjen ka japë që të anulohet dhe të shpallet në një kohë tjetër. Në rekomandim janë edhe arsyet e anulimit dhe të kësaj thirrje dhe të rishpallje të cilat janë mungesa e përfaqësimit gjithëpërfshirës të këtyre propozimeve, mangësi e konceptit në strukturë, pamjaftueshmëri teknike dhe simbolike, potencial i kufizuar për zhvillim të

mëtejshëm. Megjithatë disa nga 8 propozimet kanë pasur elemente dhe potencial për përmirësim por ato kërkojnë ndërhyrje të thella dhe thirrja nuk lejohet të kërkohej nga propozuesi që të ndërhyjë dhe për këtë kemi vendosur që ta anulojmë dhe ta rishpallim edhe njëherë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- a keni diskutime për këtë pikë nëse jo, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës

9. Kërkesë nga Kryqi i Kuq për ndihmë financiare

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- kjo kërkesë ka të bëjë me shpenzimet e ujit, rrymës, mbeturinave, telefonisë fikse etj në vlerë prej 1980, a e dëshiron dikush fjalën për këtë pikë, nëse jo vazhdojmë me procedurë të votimit

Kush është për pikën e 9-të

Për.....16

Kundër.....0


Abstenim.....0

10. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera, nëse jo e shpalli të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet në orën 10:30

Procesmbajtës


Sabile Arifi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës


Liridon Kastrati





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.320, datë:02.09.2025

Bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja d), nenin 13, nenin 24, paragrafët 24.1 dhe 24.2, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja b), dhe nenin 58, shkronja i) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008); nenin 61 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; nenin 2, paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal; Qarkoren Buxhetore 2026/01 me numër protokoli 1508/2025 të datës 15.05.2025 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; nenin 46, shkronja b), si dhe udhëzimet mbi përpilimin dhe miratimin e Buxhetit Vjetor; nenin 61 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; draft-buxheti Sh.02.Nr.23873 të datës 01.09.2025; si dhe nenin 38, paragrafi 38.1, shkronja b), nenin 70, paragrafi 70.1, shkronja i), dhe nenin 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më ----2025, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për miratimin e Buxhetit Komunal për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027–2028

1. Buxheti Komunal për vitin 2026 planifikohet në bazë të obligimeve dhe detyrave që dalin nga Statuti i Komunës së Kamenicës dhe është i bazuar në realizimin e buxhetit komunal për vitin 2025, buxhetin e Komunave të Kosovës për vitin 2026 të përcaktuar nga Komisioni i Granteve Qeveritare dhe të miratuar nga Ministria e Financave, në mbështetje të Qarkores Buxhetore 2026/01, Qarkores Buxhetore 2026/02, buxhetimit programor, si dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028 për të hyrat dhe shpenzimet, për programet buxhetore sipas kategorive ekonomike, dhe atë nga Granti Qeveritar dhe nga të hyrat vetanake.
2. Buxheti Komunal sipas fondeve burimore për vitin 2026 është 15,605,103.00 €.

2.1 Granti Qeveritar 14,381,187.00 €.

- 2.1.1. Granti i përgjithshëm: 6,452,896.00 €
- 2.1.2. Granti specifik për arsim: 5,688,769.00 €
- 2.1.3. Granti specifik për shëndetësi: 2,019,522.00 €
- 2.1.4. Granti i shërbimeve sociale rezidenciale: 220,000.00 €

2.2 Të hyrat vetanake: 1,223,917.00 €.

2.3 Buxheti komunal sipas kategorive ekonomike për vitin 2026 është 15,605,103.00 €.

- 2.3.1. Paga dhe medetje: 10,027,900.00 €
- 2.3.2. Mallra dhe shërbime: 2,440,411.00 €
- 2.3.3. Shpenzime komunale: 262,000.00 €
- 2.3.4. Subvencione dhe transfere: 930,000.00 €
- 2.3.5. Investime kapitale: 1,944,792.00 €

- 3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027–2028 / Tabela 4.1, 4.2, 4.3, si dhe tabelat e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor 2022–2026.
- 4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës.
- 5. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës, në përputhje me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

T'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit Profesional të Kuvendit, Zyres për përkthime, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe QSHQ - Arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

REFERENC-Ë:					
PËR/ZA/TO:		Kryetarin e Komunës - z. Kadri Rahimaj Kryesuesin e Kuvendit Komunal-z .Liridon Kastrati			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		U.D Drejtor DFB-së - z. Selami Zylfiu			
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:		Propozim Buxheti 2026-2028			
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. Kancelarije:		Lokacija:		Datum:	01.09.2025
Room No:		Extencion:		Date:	
Për aktivitet/Za aktivnost/For action/					
Për miratim/Za usvajanje/For aprova/					X
Për nënshkrim/Za potpis/ For signature/					
Për komente/Za komentare/For comments/					
A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May we discuss/					
Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention/					
Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed/					
Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/					
Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur/					
Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/					
Afati/ Rok/Deadline/					

Të nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 61 Shqyrtimi i Buxhetit Komunal nga Kuvendi Komunal paragrafi 61.2 Pas pranimi të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjiore të komunës. Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal deri më datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet ta shqyrtoj, ndryshoj siç e shih të nevojshme ose të arsyeshme si dhe të miratojë dhe t'ia dorëzoj Ministrisë propozim-buxhetin komunal.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



KAMENICË

DRAFT-BUXHETI I KOMUNES SË KAMENICËS PËR VITET 2026-2028

DOKUMENT PLANIFIKUES I FINANCEVE KOMUNALE



Kamenicë, 01.09.2025

HYRJE

Dokumenti paraqet një profil të shkurtër të komunës, i cili përmbanë një pasqyrë të përgjithëshme të buxhetit komunal, zhvillimit të procesit buxhetor, strukturës së financimit, synimet e qeverisë lokale, kufijt e financimit, konkluzionet përmbyllëse dhe caktimin i prioriteteve sipas tabelave të shpërndarjes të buxhetit sipas drejtorive dhe kategorive të shpenzimeve dhe trendet në tre vitet e fundit, si dhe listën e projekteve të investimeve kapitale të planifikuara nga komuna për vitet 2026-2028

PROFILI I KOMUNES – KAMENICA

Komuna: KAMENICA

Popullsia: 22868

Sipërfaqja: 414,62 km²

Struktura e Kuvendit Komunal:

Kryetari i Komunës: z. Kadri Rahimaj


Kuvendi Komunal: 27 anëtarë

Drejtoritë komunale:

Administrata e Përgjithshme
Arsimi
Ekonomi, Financave dhe Buxhetit
Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinor
Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Shërbime Publike
Investime Kapitale
Kulturë, Rini dhe Sport
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimi Rural
Inspektoriati
Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë

Struktura organizative e Komunës së Kamenicës

Tabela: Struktura e organizative e Komunës së Kamenicës



PASQYRA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT KOMUNAL

Shqyrtimet Hyrëse:

ECURIA E HARTIMIT TË BUXHETIT ËSHTË BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË SI DHE QARKOREVE BUGJETORE NGA MFPT

Neni 61

61.1 Pas miratimit të propozim –Buxhetit komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës,deri me 1 shtator të vitit përkatës fiskal,duhet t`ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal.

61.2 Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës .Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal, deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet të shqyrtojë, ndryshojë siq e sheh të nevojshme ose të arsyshme si dhe të miratojë dhe t`ia dorëzojë Ministrit propozim-buxhetin Komunal.

61.3 Buxheti i miratuar Komunal duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji dhe udhëzimet e dhëna në qarkoret buxhetore të nxjerra nga Ministri.

Aktivitetet dhe Zhvillimet Buxhetore

Procesi i planifikimit të buxhetit, është zhvilluar në përputhje të plotë me kalendarin kohor të përcaktuar nga MF-ja sipas :

- Qarkores Buxhetore 2026/01 të pranuar më 15.05.2025
- Qarkores Interne Buxhetore 1- të dërguar Drejtorëve me 15.05.2025
- Qarkores së dytë 2026/02 të pranuar më datë 21.08.2025
- Qarkores së dytë interne 2-të dërguar Drejtorëve 22.08.2025
- Dëgjimeve Buxhetore /Sipas orarit të takimeve me qytetar dhe grupe të interesit janë realizuar 26 dëgjime Buxhetore me një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish.

Komuna e Kamenicës në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë komunale ka planifikuar buxhetin për vitin 2026-2028 duke u bazuar edhe në Buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në aktivitetet dhe prioritet e tyre.

Më 30.06.2025, Kuvendi Komunal-Kamenicë ka miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 si pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e hartuar në përputhje me procedurat e parashikuara buxhetore 2026-2028, të dhëna nga MF përmes Qarkores Buxhetore 2026/01 dhe Qarkores Buxhetore 2026/02.

Korniza Afatmesme Buxhetore si dokument strategjik prezenton parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore, strategjinë zhvillimore komunale, totalët e vlerësuara të të hyrave nga të gjitha burimet e financimit, caqet totale të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike. Korniza Afatmesme buxhetore 2026-2028 është dorëzuar në MF më datë **30.06.2025**.

Komuna e Kamenicës, për vitin 2026 ka një rritje të buxhetit duke krahasuar me vitin 2025 (**322,480.00**)€

apo shprehur në përqindje **2.11%**, Ky realitet mundëson të konstatojmë se kjo rritje buxhetore ka rrjedhë si pasojë e rritjes së Grandeve Qeveritare dhe të hyrave komunale.

Zhvillimi i procesit buxhetor komunal për vitin 2026-2028

Me qëllim të përmbushjes së afatit ligjor për përgatitjen e projekt buxhetit 2026, është thelbësore që Komuna e jonë ka vepruar në pajtim me kalendarin buxhetor të përcaktuar në LMFPP në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2026/01 dhe 2026/02.

Organizata jonë buxhetore (653) ka zhvilluar procesin e hartimit të draft-buxhetit për vitet 2026-2028, në harmoni të plot me instruksionet e pranuar nga Ministria e Financave përmes qarkoreve buxhetore, si dhe zbatimit të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me qëllim që finalizimi të jetë në përputhje me interesat e përgjithshme të qytetarëve të komunës sonë, në përputhje me kufijt e limituar të financimit. Projekt-buxheti sipas burimeve të financimit, përmban edhe projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale të shpërndara në pesë kategori buxhetore dhe nënkategori të shpenzimeve.

Ministria e Financave ka hartuar qarkoret buxhetore bazuar në të dhënat e përcaktuara nga Komisioni i Granteve i cili ka mandatin e përcaktimit të vlerës së granteve duke zbatuar kriteret e përcaktuara si numri i popullsisë, madhësia gjeografike, numri i nxënësve, stafi i mësimënsve, stafi profesional dhe ndihmës, numri i pakicave kombëtare etj. Nga këto përcaktime të Komisionit të Granteve ka rezultuar se buxheti i organizatës sonë buxhetore për vitin 2026 do të jetë në shumën prej **15,605,103,00€**.

STRUKTURA E FINANCIMIT BUXHETOR

Struktura e financimit buxhetor të komunës përbëhet prej dy burimeve të financimit dhe atë:

1. GRANDI QEVERITAR 2026 :

- Granti i përgjithshëm,
- Granti specifik i arsimit,
- Granti specifik i shëndetësis dhe
- Granti i Shërbimeve Sociale Rezidenciale

2.TË HYRAT VETJAKE KOMUNALE 2026

Struktura e Financimit-Grandet Qeveritare


Pershkrimi	2026	Pjesëmarrja në %
Grandi i pergjitheshem	6,452,896.00	41.35
Grani i Arsimit	5,688,769.00	36.45
Grandi i shendetesise	2,019,522.00	12.94
Shërbimet Sociale Rezidenciale	220,000.00	1.41
Të hyrat vetjake	1,223,917.00	7.85
TOTALI	15,282,624.00	100.00

Buxheti i vitit 2026 krahasuar me vitin 2025 karakterizohet me një rritje të shumës buxhetore për grantin qeveritar, Grandin e Shëndetësisë, Grandin e Shërbimeve Sociale Rezidenciale si të hyrave vetjake. Mbështetur në totalin e buxhetit për vitin 2026, rezulton se kemi rritje të vlerës buxhetore krahasuar me vitin 2025 për 2.11 %.


Paraqitja Grafike e Grandit të Përgjithshëm për vitet 2024-2028



Paraqitja Grafike e Grandit të Arsimit për vitet 2024-2028




Paraqitja Grafike e Grandit të Shëndetësisë për vitet 2024-2028



Paraqitja Grafike e Grandit të Shërbimeve Sociale Rezidenciale për vitet 2024-2028



Paraqitja Grafike e të hyrave vetanake për vitet 2024-2028



Paraqitja grafike e trendit të rritjes Buxhetit 2024-2028



Gjendja aktuale sipas planifikimit buxhetor

Në bazë të planifikimit të buxhetit për vitin 2026 dhe krahasuar me buxhetin 2025 Komuna e Kamenicës ka ndryshime në kategori të caktuara ekonomike.

Shpenzimet rrjedhëse: Programet /Drejtoritë/ kanë bërë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha drejtoritë iu janë përmbajtur kufijve të dhënë në bazë të Qarkorës 2026/02. për vitet 2026-2028. Shpenzimet operative për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028 do të pësojnë ngritje të lehtë në krahasim me vitin 2025. Kjo rritje ka të bëjë kryesisht me rritje në kategoritë ,Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Investimeve Kapitale.

Punësimi: Bazuar në Qarkoren buxhetore 2026/01 dhe në instruksionet e dhëna për komunën e Kamenicës për vitin 2026 kemi një shkurtim të stafit sipas tabelave dhe shënimeve nga Qarkorja 2026/01.

- Nga tabela e të dhënave statistikore dhe shpërndarja e grantit specifik për arsimin parauniversitar për vitet 2026-2028 kolona ndryshim të stafit kemi zvoglim prej 50 pozitave.
- Politikat e reja nga Komisioni i Grandeve të kolona numri i personelit ndihmës për cerdhet e reja 2026 kemi një rritje të stafit prej 3 pozitave.
- Nga tabela Granti specifik për Shëndetësi primare për vitet 2026-2028 të kolona politikë e re në fëmijëri të hershme aprovuar nga Komisioni i Grandeve kemi një rritje të stafit prej 4 edhe atë: Logoped, Psikolog, Fzioterapeut, Punëtor Social.
- Bazuar nga rexhistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë, Komuna e Kamenicës hyn në radhët e Komunave me nga 20,000 deri në 30,000 banor dhe numri i delegateve të Kuvendit Komunal do të jetë nga 27 në 21 delegat.

Në total stafi për Komunën e Kamenicës për vitin 2026 do të jetë 1,105 nga 1154 në vitin 2025

.Kategoria për Paga dhe Mëditje

Për Pagat dhe mëditjet bazuar nga Qarkorja 2026/01 Komuna ka planifikuar në bazë të;

1. Pagës sipas muajit Mars 2025 bazuar në 12 muaj
2. Rritja nga muaji Korrik 2025 në shumë prej 55.00€
3. Pozitat e pa plotësuara bazuar nga pagën mesatare të Kosovës dhe nga shuma e kalkuluar 40% të buxhetit për atë pozitë
4. Rregullorja komunale për sistematizim të vendeve të punës.

..Krahasuar me vitin 2025 rritja e kategorisë për Paga dhe Mëditje, për vitet 2026-2028 do të jetë 1%, ndërsa vetëm për vitin 2025 do të jetë 9.17%

. Kriteret që janë marrë për bazë në këtë kategori janë:

- Gjendja e tanishme e punëtorëve aktual,
- Stafi i zvogluar dhe harmonizimi sipas nënprogrameve
- Punëtorët me pushim pa pagesë
- Punëtorët në pushim të lehonisë
- Numri i pozitave në procedure /konkurse/
- Kontrata kolektive

Kategoria për Mallra dhe shërbime

Kjo kategori ka një rritje të lehtë prej prej 0.76% në krahasim me vitin 2025. Pjesëmarrja e kategorisë për mallra dhe shërbime në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, për vitin 2026 do të jetë 15.64%. Kjo rritje është bazuar në rritje të cmimeve për furnizime dhe shërbime.

Kategoria për shpenzime Komunale

Në bazë të kufijve të caktuar nga Qarkorja 2026/02 për vitin 2026-2028 del se komuna e Kamenicës ka bërë planifikimin e buxhetit të njejte. Pjesëmarrja e kategorisë për shpenzime komunale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës gjatë vitit 2026 të jetë 1.68% ndërsa krahasuar me vitin 2025 është e njejt.

Kategoria per Subvencione

Në bazë të kufijve të caktuar nga Qarkorja 2026/02 për vitin 2027-2028 del se komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit të rritur krahasuar me vitin 2025. Kemi kërkesa për subvencionim për biznese të ndryshme dhe aktivitetet e planifikuara nga Grupi i grave dhe Drejtoria për Ekonomi, kërkesa për subvencionim edhe në përkrahje të bujqve të Komunës, subvencionimi në Drejtorinë për KRS për aktivitetet vjetore /manifestimet/ dhe përkrahjen e klubeve të ndryshme. Pjesëmarrja e kategorisë për subvencione në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë vitit 2026 do të jetë 5.96%,ndërsa krahasuar me vitin 2025 ka rritje prej 5.08%.

Kategoria per Investime kapitale

Në bazë të kufijve të dalur nga Qarkorja 2026/02 për vitin 2026-2028 del se komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit më të ultë krahasuar me vitin 2025, pra ka një zvoglim prej **23.07 %** apo (583,299.00) €.Ky zvoglim ka rezultuar të jetë si rezultat i ndarjes dhe rritjes së Grandit të Përgjithëshëm dhe rritjes së koeficientit për kategori të Pagave dhe Meditjeve, Pjesëmarrja e kategorisë për Investime kapitale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë këtij viti 2026 do të jetë **12.46% .**

Tabela e shpërndarjes sipas kategorive ekonomike

	2025	2026	Dallimi	
Paga dhe Meditja	9,185,435.00	10,027,900.00	842,465.00	109.17
Mallra dhe Shërbime	2,422,098.00	2,440,411.00	18,313.00	100.76
Shpenzime Komunale	262,000.00	262,000.00	-	100.00
Subvencione	885,000.00	930,000.00	45,000.00	105.08
Investime kapitale	2,528,091.00	1,944,792.00	(583,299.00)	76.93
TOTALI	9,185,435.00	10,027,900.00	322,480.00	109.17

Në kuadër të administratës së organizatës sonë buxhetore(653) janë paraparë me organogram të miratuar në Kuvend të komunës këto programe :

01-Zyra e Kryetarit

02-Zyra e Kuvendit

03-Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

- *Cështja Gjinore*

04-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

05-Sherbimet Publike Ambientit dhe Inspektoratit

Në kuadër të Shërbimeve Publike janë paraparë nënprogramet:

- *Infrastruktura Publike*
- *Zjarrëfikësit dhe Inspekcioni*

06-ZLK

07-Bujqësia

08-Shërbimet Kadastrale

09-Urbanizmi dhe Planifikimi Hapsinor

-Drejtoria e Investimeve

10-Ekonomi,Zhvillim dhe Diasporë

11-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

- *Administrata e Shëndetësisë*
- *Shërbimet e shëndetësisë primare*

Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale

- *Shërbimet Sociale*
- *Shërbimet sociale rezidenciale*

12-DKRS

13-Arsimi

Kufijt e financimit

Qarkorja buxhetore 2026/02 ofron instruksione mbi ecurin e procesit të hartimit të buxhetit, përcakton qartë edhe limitet e financimit për të gjitha kategoritë. Kategoritë e shpenzimeve operative/ Paga dhe

mëditje, Mallra dhe Shërbime, Komunali, Subvencione dhe Investimeve kapitale kanë një kufi të përbashkët.

Buxheti i vitit 2026 është i financuar nga dy burime: 1) **Granti qeveritar**, dhe
2) **Të hyrat vetjake**.

Financimi i Buxhetit nga grandit qeveritar vazhdon të jetë burimi kryesor i përbërjes së buxhetit të komunës. Pothuajse çdo vit kemi shënuar ngritje të vlerës së grantit qeveritar përfshirë të katër grantet, për vitin 2026, kemi një ngritje të grandit qeveritar për 1.64%. Granti qeveritar si burim parësor i bërjes së buxhetit për vitin fiskal 2026 ka pjesëmarrje prej **92.16%** në totalin e vlerës buxhetore.

Tabela e financimit të Grandit Qeveritar

Nr	Emërtimi i Grandit	Shuma e Grandit Qeveritar	Buxheti Total	Pjesemarrja %
1	Grandi Qeveritar	14,381,187.00	15,605,104.00	92.16
	TOTALI	14,381,187.00	15,605,104.00	92.16

Krahasuar me vitin 2025 totali i Grandeve në vitin 2026 është rritur për 1.64% nga se kemi rritje të Grandit Arsimit 4.69%.

	Grandet Qeveritare 2025	Grandet Qeveritare 2026	Ndryshimi
TOTALI	14,148,552.00	14,381,187.00	232,635.00
	14,148,552.00	14,381,187.00	232,635.00

2. TË HYRAT VETJAKE

Burimi i dytë i financimit të buxhetit, të hyrat vetjake, marrin pjesë me **7.84%** të përbërjes së buxhetit për vitin 2026, dhe krahasuar me vitin 2025 kemi një **trend të rritjes** të vlerës së planifikuar për 7.92%.

	Te hyrat totale vetjake 2026	Totali i Buxhetit 2026	Pjesemarrja
Te hyrat Vetjake	1,223,917.00	15,605,104.00	7.84%
TOTALI	1,223,917.00	15,605,104.00	7.84%

Përmes planit të të hyrave 2026 organizata buxhetore pasqyron totalin e planifikuar për vitin buxhetor duke patur për bazë vlerën vjetore si objektiv, si dhe duke e shpërndarë vlerën e parashikuar në të gjitha llojet e të hyrave.

TABELA E BUXHETIT NGA TE HYRAT VETANAKE 2025/2026

	Të hyrat 2025	Të hyrat 2026	Diferenca	Ndryshimi
Te Hyrat Vetjake	1,134,072.00	1,223,917.00	89,845.00	107.92
TOTALI	1,134,072.00	1,223,917.00	89,845.00	107.92

Gjithsesi duhet theksuar se bazë ligjore për grumbullimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake janë ligjet e miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës si: Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligji mbi Financat Lokale, rregullorja e komunës mbi tarifat dhe ngarkesat komunale si dhe ligji mbi Tatimin në Pronë.

Tatimi në pronë

E hyra kryesore në kuadër të të hyrave vetanake është **Tatimi në Pronë 481,693.00 së bashku me Tatimin në tokë 120,667.00 e që në total është 621,557.00**, pjesëmarrja në totalin e planifikimit të të hyrave për vitin fiskal 2026 do të jetë **50.78%**

Të hyrat nga Arsimi: Janë të hyra që vijnë kryesisht nga participimi i qytetarëve për shërbimet që kryhen në qerdhen e fëmijëve, si dhe të hyrat nga pagesat për arsimimin e përshpejtuar ;

Të hyrat nga shëndetësia: janë të hyrat që kanë të bëjnë me participimet në shëndetësi nga ana e qytetarëve.

1. Përcaktimi i prioriteteve

Është e qartë se një ndër segmentet më të rëndësishëm në procesin e hartimit të buxhetit është ai i përcaktimit të prioriteteve sidomos në pjesën e kategorisë së investimeve kapitale. Bazë e përcaktimit të prioriteteve janë nevojat e qytetarëve të komunës sonë për të ngritur mirëqenien e tyre. Mbi bazën e këtyre nevojave kryetari i Komunës së bashku me stafin e tij si dhe në konsultimin me qytetarët e në varësi me mjetet e disponueshme do të ketë përcaktuar prioritetet 2026-2028 në fokus ato të vitit fiskal 2026.

2. Buxheti në funksion të përmbushjes së nevojave.

Organizata jonë buxhetore ka të identifikuar nevojat për zhvillim të gjithëmbarshtëm por që janë në disproporcion me mundësitë buxhetore. Edhe buxheti i vitit fiskal 2026 do të ndikoj në masë të konsideruar në zhvillimin e komunës sonë në të gjitha sferat por, asesi nuk mundë të përmbushë kërkesat e përgjithëshme qytetare. Në këtë drejtim absorbimi i granteve të donatorëve qofshin ato te mbredshme apo te jashtme do të ndikoj pozitivisht në ngritjen e trendit në realizimin e kërkesave zhvillimore e sociale.

3. Buxheti në përkrahje të zhvillimit ekonomik

Vlera e limituar e buxhetit jep hapsirë dhe mundësi për një ndikim të theksuar në fushën e zhvillimit ekonomik të komunës sonë.

4. Identifikimi i nevojave

Zakonisht Kryetari i Komunës së bashku me stafin e tij në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit duhet të organizojë dëgjime buxhetore me qytetarë. Për vitin 2026 janë mbajtur 26 dëgjime buxhetore. Janë bërë raport përmbledhës për nevojat dhe prioritetet e tyre, kemi propozimet e qytetarëve të marrë në mënyrë individuale dhe nga kryetaret e Këshillave Lokale.

Në këtë drejtim roli i qytetarëve është i pazëvendësueshëm, dhe lypset nga ata që përherë të jenë pjesë e vendim marrjes së vendosur në procesin e hartimit të projekt buxhetit, përmes të cilit ata do të mundë të realizojnë synimet, projektet e tyre në funksion të ngritjes së mirëqenies, Është për tu përmendur se nga shuma e planifikuar e Tatimit në Pronë prej 621,557.00 duhet të planifikohet buxheti për investime kapitale që mjetet e inkasuara tu kthehen qytetarëve me investime kapitale.

1.SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË PROGRAME BUXHETORE

Në kapitullin II të këtij dokumenti do të paraqesim shpërndarjen e buxhetit për vitin 2026 në programet buxhetore, kategori dhe nënkategori buxhetore.

Shpërndarja buxhetore në kategori ekonomike gjithnjë është në varshmëri me përcaktimet apo limitet buxhetore të pranuar me qarkoren buxhetore 2026/02.

BUXHETI	2024	2025	2026	2027	2028	Diferenca	Progresi		
							1	2	Progresi
							2026-2025	2027-2026	2028-2027
Nr. Punetoreve	1.140	1.154	1.105	1.105	1.105	(49)	96	100.00	
Grandi i Përgjith.	5.976.303.00	6.452.896.00	6.452.896.00	5.742.213.00	6.196.672.00	-	100.00	88.99	107.91
Grandi i Arsimit	5.440.648.00	5.433.969.00	5.688.769.00	5.859.432.00	6.035.215.00	254.800.00	104.69	103.00	103.00
Grandi i Shëndetësisë	1.892.973.00	2.041.687.00	2.019.522.00	2.080.107.00	2.142.510.00	(22.165.00)	98.91	103.00	103.00
Shërb. Sociale Rezidenciale	197.272.00	220.000.00	220.000.00	200.000.00	200.000.00	-	100.00	90.91	100.00
Total Grandet	13.507.196.00	14.148.552.00	14.381.187.00	13.881.752.00	14.574.397.00	232.635.00	101.64	96.53	104.99
Te hyrat vetanake	1.016.621.00	1.134.072.00	1.223.917.00	1.315.257.00	1.321.154.00	89.845.00	107.92	107.46	100.45
Totali	14.523.817.00	15.282.624.00	15.605.104.00	15.197.009.00	15.895.551.00	322.480.00	102.11	97.38	104.60
Paga dhe medijtja	8.980.426.00	9.185.435.00	10.027.900.00	10.078.039.00	10.128.430.00	842.465.00	109.17	100.50	100.50
Mallra dhe shërbime	2.274.272.00	2.422.098.00	2.440.411.00	2.440.411.00	2.440.411.00	18.313.00	100.76	100.00	100.00
Shpenzime komunale	254.000.00	262.000.00	262.000.00	265.500.00	269.650.00	-	100.00	101.34	101.56
Subvencione	648.000.00	885.000.00	930.000.00	930.000.00	930.000.00	45.000.00	105.08	100.00	100.00
Investime Kapitalë	2.367.119.00	2.528.091.00	1.944.792.00	1.483.059.00	2.127.060.00	(583.299.00)	76.93	76.26	143.42

Buxheti 2026-2028

Programi	Stafi	Paga	Mallra dhe Sherbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Invest Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	29	389,046.00	255,000.00		260,000.00		904,046.00
Zyra e Kuvendit Komunal	27	220,928.00	10,000.00				230,928.00
Administrata dhe Personeli	35	304,332.64	180,000.00				484,332.64
Ceshnja Gjimore	1	8,192.00	5,000.00		10,000.00		23,192.00
Buxhet dhe Financa	25	235,103.93	20,000.00				255,103.93
Ekonomi dhe Diaspore	5	62,743.75	42,000.00		170,000.00		274,743.75
Infrastruktura Publike	20	237,195.67	400,000.00	165,000.00			802,195.67
Zjarrefikset dhe Inspektimet	33	349,311.00	45,000.00				394,311.00
Bujqësi dhe Pylltari	9	78,349.38	35,000.00		160,000.00		273,349.38
Kadaster dhe Xheodezi	11	114,317.00	10,000.00				124,317.00
Urbanizem	10	112,965.86	50,000.00				162,965.86
Investimet Kapitale	6	50,721.80	70,000.00				120,721.80
Administrata -Shendetësi	4	38,964.20	40,000.00				78,964.20
Shërbimet e Shënd. Primare	165	1,756,185.56	260,000.00	32,000.00			2,048,185.56
Shërbimet sociale	13	115,428.00	15,000.00				130,428.00
Shërbimet Sociale Rezidenc.	11	109,579.20	75,000.00	10,000.00			194,579.20
Shërbimet Kulturore	18	146,717.00	70,000.00		110,000.00		326,717.00
Perkrahja e Rinisë	3	42,752.40	20,000.00		20,000.00		82,752.40
Administrata-Arsim	12	100,399.00	631,650.00	55,000.00	200,000.00		987,049.00
Arsimi Parashkollor	49	347,170.35	65,000.00				412,170.35
Arsimi Fillor	468	3,786,508.06	90,000.00				3,876,508.06
Arsimi I Mesëm	150	1,420,988.20	51,761.00				1,472,749.20
TOTALI	1105	10,027,900.00	2,440,411.00	262,000.00	930,000.00	1,944,792.00	15,605,103.00

KONKLuzionet Përmbyllëse :

- Kemi një rritje të buxhetit në krahasim me vitin 2025 për 2.11% apo (322,480.00€)
- Kemi një Grand të përgjithshëm të njëjtë me vitin 2025
- Kemi rritje me vitin 2025 të Grandit të Arsimit prej 4.69% apo në shumë prej (254,800.00)€
- Kemi një Grand të Shëndetësisë me të ulët në krahasim me vitin 2025 për 1.09% apo (-22,165.00.€)
- Ka një Grand të Shërbimeve Sociale rezidenciale të njëjte në krahasim me vitin 2025
- Kemi planifikim të të hyrave vetanake të rritur në krahasim me vitin 2025 për 7.92% apo 89,845.00€
- Ka një rritje në kategori për paga dhe mëdijtje krahasuar me vitin 2025 prej 9.17% apo (842,465.00€).
- Ka një rritje në kategori mallra dhe shërbime krahasuar me vitin 2025 prej 0.76% apo 18,31300€.
- Ka buxhet të njëjet në kategorinë shpenzime komunale krahasuar me vitin 2025
- Ka një rritje në kategori të subvencioneve krahasuar me vitin 2025 prej 5.08% apo 45,000.00€.
- Ka një zvoglim në kategori Investime kapitale krahasuar me vitin 2025 prej 23.07% apo 583,299.00€.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Nr. i faq. 1

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

Br. str.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVO
QENDRA PËR SHERBIM TË QYTYRË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐEVINA

Sh. 02 Nr. 26499

Br. 1 Data: 18/09

Datum: 2025

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Sh.02.Nr.342, datë 17.09.2025

Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13, nenit 24 dhe 58, shkronja h), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës; Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal; Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007; nenit 16, paragrafi 8, pika 8.2 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____, sjell këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin "Ndërtimi i varrezave në fshatin Karaçevë e Epërme", në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Shoqatës Firishta, Karaçevë e Epërme

1. **MIRATOHET** Propozim-Vendimi për buxhetim nga bashkëfinancimi dhe krijimin e kodit të ri për projektin "Ndërtimi i varrezave në fshatin Karaçevë e Epërme", në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Shoqatës Firishta, Karaçevë e Epërme.
2. Në kuadër të projektit të lartëcekur, Komuna e Kamenicës dhe Shoqata Firishta do të participojnë me kontribut financiar në shumën prej 106,180.75 € (njëqind e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë euro e shtatëdhjetë e pesë cent).
3. Komuna e Kamenicës me 81,677.50 € (tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë cent) dhe Shoqata Firishta me 24,503.25 € (njëzetë e katër mijë e pesëqind e tre euro e njëzetë e pesë centë).
4. Shuma e mjeteve 81,677.50 € (tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë cent) nga Komuna e Kamenicës, sipas këtij vendimi, do të participohet nga Buxheti Komunal i Kamenicës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Financa dhe Buxhet të Komunës së Kamenicës.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përkatëse për qeverisje lokale si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe Arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 26392
U. Br.

Nr. i faq. 3 Data: 17/09
Br. str. Datum:

KAMENICË 2025

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

“Ndërtimi i varrezave në fshatin Karaçevë e epërme”

Palët nënshkruese

1. Komuna e Kamenicës e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës së Kamenicës z. Kadri Rahimaj
(në tekstin e mëtejshëm Komuna), dhe
2. Shoqatës Firishta, Karaçevë e Epërme e përfaqësuar nga z. Selami Kastrati (në tekstin e mëtejshëm Shoqata Firishta).

Kamenicë, 17.09.2025

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i Projektit: **“Ndërtimi i varrezave në fshatin Karaçevë e epërme”** si dhe përcaktimi i obligimeve të Komunës së Kamenicës dhe bashkëfinancuesit Shoqata Firishta, Karaçevë e epërme.

Neni 2

Vlera e Projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

- 2.1. Projektin **“Ndërtimi i varrezave në fshatin Karaçevë e epërme”**, ka vlerë parallogaritare prej 106,180.75 € (njëqind e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë euro e shtatëdhjetë e pesë centë).
- 2.2. Komuna nga buxheti i saj vjetor i vitit 2025 financon këtë projekt në shumë prej 81,677.50 € (tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë centë).
- 2.3. Shoqata Firishta, Karaçevë e epërme, financon këtë projekt në shumë prej 24,503.25 € (njëzetë e katër mijë e pesëqind e tre euro e njëzetë e pesë centë).

Neni 3

Obligimet e Komunës së Kamenicës

- 3.1. Komuna është e obliguar që pas nënshkimit të kësaj Marrëveshjeje të hartoj projektin Kryesor dhe të siguroj tërë dokumentacionin e nevojshëm.
- 3.2. Pagesat për Projektin **“Ndërtimi i varrezave në fshatin Karaçevë e epërme”** nga Komuna do të bëhet në bazë të punimeve sipas kushteve të kontratës.
- 3.3. Komuna cakton menaxherin/ mbikëqyrësin e Kontratës.
- 3.4. Komuna është bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit sipas Legjislacionit në Fuqi.

Neni 4

Obligimet e Shoqatës Firishta, Karaçevë e epërme

Obligohet Shoqata Firishta, Karaçevë e epërme, që shumën prej 24,503.25 € (njëzetë e katër mijë e pesëqind e tre euro e njëzetë e pesë centë) të deponoj në llogari të Komunës së Kamenicës.

Neni 5
Ndyshimet dhe ndërpreja e marrëveshjes së bashkëpunimit

- 5.1. Me pëlqimin paraprak të palëve, marrëveshja e bashkëpunimit mund të ndyshohet dhe plotësohet.
- 5.2. Komuna mbanë të drejtën e shkëputjes së marrëveshjes nëse konstaton se pala tjetër nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 6
Zgjidhja e marrëveshjes

Palët zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 7
Numri i Kopjeve

Marrëveshja e bashkëpunimit për bashkëfinancim të projektit të sipërcekur është nënshkruar në katër kopje, nga dy kopje për secilën palë.


Neni 8
Vlefshmëria e marrëveshjes

Kjo marrëveshje është e vlefshme deri në përfundim të projektit të lartëcekur.

Neni 9
Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj.

Përfaqësues i Shoqatës Firishta


z. Selami Kastrati


Kryetari i Komunës
z. Kadri Rahimaj